

V E N D I M
Nr.113, datë 21.3.1994

PËR KRITERET E LLOGARITJES SË VLERËS SË PAGESËS PËR LEJEN E SHFRYTËZIMIT MINERAR

Në zbatim të nenit 50 të ligjit mineral të Shqipërisë nr. 7796, datë 17.2.1994, me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjitike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Kriteret e llogaritjes së vlerës së pagës për lejen e shfrytëzimit mineral caktohen sipas tabelave 1 dhe 2 që i bashkëngjiten këtij vendimi.
2. Vlera e pagesës për lejen e shfrytëzimit mineral për çdo km² për mineralet e grupeve I, II dhe III të llogaritet sipas tabelave 1 dhe 2 që i bashkëngjiten këtij vendimi.
3. Për mineralet e grupi V vlera e kësaj pagese është sa ekuivalenti në lekë i 10.000 frangave zvicerane në momentin e pagesës për çdo km².
4. Për mineralet e grupit VI vlera e kësaj pagese është sa ekuivalenti në lekë i 8.000 frangave zvicerane në momentin e pagesës për çdo km².
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjitike.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

KRITERET E PËRCAKTIMIT TË PAGESËS PËR LEJEN E SHFRYTËZIMIT MINERAR

Tabela 1. Vlera bazë e përcaktuar sipas rentabilitetit.

Vlera e Rentabilitetit	Vlefata bazë (Franga zvicerane)
Rentabiliteti	
a) 0 - 30 për qind	7.500
b) 30-50 “ “	9.000
c) mbi 50 “ “	10.000

Tabela 2 Koeficientet e konvertimit të vlerës bazë sipas kritereve që merren parasysh në llogaritjen e pagesës së lejes të shfrytëzimit mineral.

Kriteret (për qind)	Koeficienti i konvertimit
Largësia nga pika e shitjes.	
a) Deri 25 km	-
b) 25-50 km	-5
c) 50-100 km	-10
ç) Mbi 100 km	-15
Infrastruktura	
a) Ekziston	-
b) Do përmirësohet	-10
c) Bëhet e re	-15
Largësia nga qendra e banuar	
a) Deri 5 km	-

b) 5-10 km	-5	
c) 10-20 km	-10	
ç) Mbi 20 km		-15
Për procese përpunimi		
a) Shitet drejtpërdrejt	-	
b) Kalon një proces		- 5
c) Kalon 2 procese	- 10	
ç) Me shumë se 2 procese		- 15